



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

**D e k r e t o j**

Ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të nënshkruar në Prishtinë me 19 qershor 2013 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 12 nëntor 2013.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-020-2013.

Prishtinë, më 15 nëntor 2013.

---

Atifete Jahjaga  
Presidente e Republikës së Kosovës

TRAKTAT PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË  
ÇËSHTJE PENALE  
NDËRMJET  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Italisë, tani e tutje, të referuara si "Palët Kontraktuese",

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit efektiv ndërmjet dy Shteteve për të parandaluar krimin mbi bazën e respektit të ndërsjellë për sovranitet, barazi dhe përfitim të ndërsjellë,

Duke marrë parasysh që ky qëllim mund të arrihet përmes lidhjes së një traktati dypalësh që vendos rregullat për ndihmë ligjore në çështje penale,

janë pajtuar me, si vijon:

Neni 1

Fushëveprimi

1. Palët Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati, zotohen t'i ofrojnë njëra tjetrës të gjitha masat e mundshme të ndihmës ligjore reciproke në çështje penale.
2. Ndihma e tillë duhet të përfshijë:
  - (a) Gjetjen dhe identifikimin e personit;
  - (b) Dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave të ndërlidhura me procedura penale;
  - (c) Thirrjen e dëshmitarëve, viktimave, të pandehurve në procedura penale si dhe të ekspertëve që të shfaqen vullnetarisht para Autoritetit kompetent të Shtetit Kërkuar;
  - (d) Sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve, të dhënave dhe dëshmive;
  - (e) Marrjen dhe dërgimin e opinionëve të ekspertëve;
  - (f) Marrjen e dëshmive ose deklaratave të personave;

- (g) Marrjen në pyetje;
  - (h) Transferimin e personave në mbajtje për të dëshmuar ose për të marr pjesë në aktivitete tjera procedurale;
  - (i) Kryerjen e inspektimeve gjyqësore ose ekzaminimin e lokacioneve ose sendeve;
  - (j) Kryerjen e hetimeve, kërkimeve, ngrirjen e aseteve dhe konfiskimin;
  - (k) Konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe sendeve të ndërlidhura me veprën penale;
  - (l) Komunikimin e rezultatit të procedurave penale dhe përcjelljen e vendimeve penale si dhe informatave të marra nga regjistrat gjyqësor;
  - (m) Shkëmbimin e informatave për ligje; dhe
  - (n) Çdo formë tjetër të ndihmës që nuk është në kundërshtim me ligjet e Shtetit të Kërkuar.
3. Ky Traktat nuk duhet të vlejë për:
- (a) Ekzekutimin e fletarrestimeve dhe masave tjera kufizuese të lirisë personale;
  - (b) Ekstradimin e personave;
  - (c) Ekzekutimin e aktgjykimeve penale të shpallura në Shtetin Kërkues;
  - (d) Transferimin e personit të dënuar për qëllime të kryerjes së dënimit; dhe
  - (e) Transferimin e procedurave penale.

## Neni 2

### Inkriminimi i dyfishtë

1. Ndhimja juridike mund të ofrohet edhe kur vepra penale në të cilën kërkohet ndihma nuk paraqet vepër penale në Shtetin e Kërkuar.
2. Megjithatë, nëse kërkesa për ndihmë është e ndërlidhur me kryerjen e kërkimeve, konfiskimeve të aseteve, sekuestrimeve të mjeteve dhe aktiviteteve tjera që prekin të drejtat fundamentale të një personi ose janë invazive në lokacione ose sende, atëherë ndihma do të ofrohet vetëm nëse vepra për të cilin kërkohet është e paraparë si vepër penale edhe me ligjet e Shtetit të Kërkuar.

### Neni 3

#### Refuzimi ose shtyrja e ofrimit të ndihmës

1. Shteti i Kërkuar mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, ndihmën e kërkuar, nëse:

- (a) Kërkesa për ndihmë është në kundërshtim me ligjet e vendit ose nuk është në përputhje me dispozitat e këtij Traktati;
- (b) Kërkesa ndërlidhet me një vepër penale të natyrës politike ose me një vepër penale të ndërlidhur me vepra politike. Në këtë drejtim, veprat në vijim nuk do të konsiderohen si vepra penale politike:
  - i) Vrasja ose vepra tjera penale kundër jetës, integritetit fizik ose lirisë së Kryetarit të Shtetit ose të Qeverisë ose të një anëtarit të familjes së tij/saj;
  - ii) Veprat penale terroriste dhe çdo vepër tjetër penale që nuk konsiderohet si vepër politike nën ndonjë traktat, konventë ose marrëveshje politike, pjesë e të cilës janë të dy Palët;
- (c) kërkesa ndërlidhet në mënyrë ekskluzive me një vepër penale ushtarake në bazë të ligjeve të Shtetit Kërkuar;
- (d) vepra penale për të cilën është bërë kërkesa është e ndëshkueshme nga Shteti Kërkuar me një lloj të dënimit që është i ndaluar me ligjet e Shtetit të Kërkuar;
- (e) ka arsye të mjaftueshme për të besuar se kërkesa bëhet me qëllim të hetimit, ndjekjes penale, dënimit ose promovimit të llojeve tjera të veprimeve kundër një personi mbi baza racore, gjinore, fetare, kombësie apo mendimi politik ose që pozita e atij personi mund të paragjykohet nga ndonjëra prej këtyre arsyeve;
- (f) tanimë kanë filluar procedurat penale ose është marrë aktgjykimi final në lidhje me po atë person dhe po për të njëjtën vepër penale të theksuar në kërkesën për ndihmë ligjore;
- (g) konsiderohet se ekzekutimi i kërkesës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesat tjera esenciale të Shtetit ose mund të shkaktojë pasoja që janë në kundërshtim me parimet fundamentale të ligjeve vendore.

2. Shteti i Kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës për ndihmë nëse ekzekutimi i kërkesës do të ndikonte në ndonjë procedurë penale aktuale në Shtetin e Kërkuar.

3. Para refuzimit të kërkesës ose shtyrjes së ekzekutimit të saj, Shteti i Kërkuar ka mundësinë e konsiderimit të ofrimit të ndihmës së kushtëzuar. Në këtë drejtim, Autoritetet Qendrore të secilit Shtet, të parapara në nenin 4 të këtij Traktati, duhet të konsultohen me njëra tjetrën dhe, nëse Shteti Kërkuar pranon ndihmën e

kushtëzuar, atëherë kërkesa duhet të ekzekutohet në përputhje me modalitetet e miratuara.

4. Në rastet kur Shteti i Kërkuar e refuzon ose shtynë ofrimin e ndihmës juridike, atëherë duhet të informojë Shtetin Kërkuar me shkrim për arsyet e shtyrjes ose të refuzimit të tillë.

#### Neni 4

##### Autoritetet Qendrore

1. Për qëllimet e këtij Traktati, kërkesat për ndihmë juridike do të përcillen përmes Autoriteteve Qendrore të caktuara nga Palët Kontraktuese. Autoritetet Qendrore do të komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ndërmjet tyre rreth zbatimit të dispozitave të këtij Traktati.

2. Autoritetet Qendrore janë Ministero della Giustizia (Ministria e Drejtësisë) e Republikës së Italisë dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës.

3. Secila Palë Kontraktuese duhet t'i komunikojë tjetrës, përmes kanaleve diplomatike, ndryshimin e Autoritetit Qendror të caktuar.

4. Autoritetet Qendrore do të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën dhe, sipas kërkesës, të ofrojnë informata rreth statusit të kërkesave të dorëzuara për zbatimin e këtij Traktati.

#### Neni 5

##### Forma dhe përmbajtja e kërkesave

1. Kërkesa për ndihmë bëhet me shkrim dhe duhet të jetë e nënshkruar ose e vulosur nga Autoriteti kërkuar në përputhje me ligjet e veta.

2. Kërkesa për ndihmë duhet të përfshijë, si vijon:

- (a) Emrin e autoritetit kompetent që kryen hetimin ose procedurat penale me të cilat ka të bëjë kërkesa;
- (b) Një përshkrim të fakteve të rastit, përfshirë kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale dhe çdo dëm të shkaktuar si dhe kualifikimin ligjor të tyre;
- (c) Referenca të dispozitave ligjore të aplikueshme, përfshirë dispozitat e parashkrimi dhe rreth dënimit që mund të shqiptohet;
- (d) Një përshkrim të aktiviteteve të kërkuara;
- (e) Afatin kohor brenda të cilit duhet të ekzekutohet kërkesa, në rastet e urgjencave;

- (f) Të dhëna për personat që mund të lejohen të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të kërkesës, në përputhje me nenin 6 paragrafi 3 më poshtë;
- (g) Informatat rreth shtesave dhe kompensimeve në të cilat ka të drejtë personi i thirrur nga Shteti Kërkuar me qëllim të marrjes së dëshmi, në përputhje me nenin 10, paragrafi 3, më poshtë;
- (h) Çdo informatë të domosdoshme për të marrë si dëshmi përmes video-konferencës, në përputhje me nenin 14, paragrafi 5, më poshtë.

3. Kërkesa për ndihmë, për aq sa është e nevojshme dhe për aq sa është e mundur, duhet të përfshijë edhe:

- (a) Informata rreth identitetit të personave nën hetim ose kundër të cilëve zhvillohet ndjekja penale;
- (b) Informatat rreth identitetit të personit që duhet identifikuar dhe gjetur si dhe të vendit ku ai person mund të jetë;
- (c) Informatat rreth identitetit dhe vendbanimit të personit tek i cili do të bëhet shërbimi i dokumenteve dhe statusit të tij/saj në lidhje me procedurën, si dhe mënyrën në të cilën duhet të bëhet shërbimi;
- (d) Informatat rreth identitetit dhe vendbanimit së personit që duhet të jap dëshmi ose të jap deklarata tjera;
- (e) Lokacionin dhe përshkrimin e vendit ose sendit që duhet të inspektohet ose ekzaminohet;
- (f) Lokacionin dhe përshkrimin e vendit që duhet të kontrollohet dhe informatat për sendet që duhet sekuestruar ose konfiskuar;
- (g) Informatat për çdo procedurë të veçantë të kërkuar për të ekzekutuar kërkesën dhe arsyet relevante për të;
- (h) Informata rreth kërkesave për konfidencialitet;
- (i) Çdo informatë tjetër e cila mund të lehtësojë ekzekutimin e kërkesës.

4. Nëse Shteti i Kërkuar konsideron se përmbajtja e kërkesës nuk është e mjaftueshme për të përmbushur kushtet e parapara me këtë Traktat, atëherë Shteti në fjalë mund të kërkojë informata shtesë.

5. Kërkesa për ndihmë juridike dhe dokumente përcjellëse të dorëzuara në bazë të këtij neni duhet të shoqërohet me përkthim në gjuhën e Shtetit të Kërkuar, që është gjuha Shqipe ose Serbe për Republikën e Kosovës dhe gjuha Italiane për Republikën e Italisë.

6. Kërkesa për ndihmë juridike, e parashtruar përmes Autoriteteve Qendrore të dhëna në nenin 4 më sipër, mund të dorëzohet edhe përmes çdo forme të shpejtë të komunikimit, përfshirë teleksin, faksin dhe emailin. Në raste të tilla, kërkesa formale duhet të arrijë brenda tetëmbëdhjetë ditëve nga data e dërgimit fillestar përndryshe kërkesa për ndihmë do të anulohet.

## Neni 6

### Ekzekutimi i kërkesave

1. Shteti i Kërkuar duhet të bëjë ekzekutimin e menjëhershëm të kërkesës për ndihmë, në përputhje me ligjet e veta. Në këtë drejtim, organi gjyqësor i Shtetit të Kërkuar duhet të nxjerrë ftesën, urdhrat për kërkim, urdhra relevant për sekuestrime ose konfiskime ose çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për ekzekutimin e kërkesës.
2. Me kusht që të mos jetë në kundërshtim me ligjet vendore, Shteti i Kërkuar duhet të ekzekutojë kërkesën për ndihmë në përputhje me modalitetet e kërkuara nga Shteti Kërkues.
3. Me kusht që të mos jetë në kundërshtim me ligjet vendore, Shteti i Kërkuar mund të autorizojë personat e specifikuar në kërkesën për ndihmë juridike që të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të kërkesës. Në këtë drejtim, Shteti i Kërkuar duhet të informojë, në kohë të arsyeshme, Shtetin Kërkues për datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë. Personat të cilët janë autorizuar, përmes autoriteteve kompetente të Shtetit të Kërkuar, mund të bëjnë pyetje që ndërlidhen me aktivitetin e kërkuar, të marrin drejtpërsëdrejti - gjatë marrjes së dëshmimeve - çdo dokument relevant për dëshmitë në fjalë ose të kërkojnë ekzekutimin e aktiviteteve tjera hetuese të cilat janë të ndërlidhura me aktivitetet e mësipërme.
4. Shteti i Kërkuar duhet të informojë, brenda një afati të arsyeshëm, Shtetin Kërkues për rezultatin e ekzekutimit të kërkesës. Nëse ndihma e kërkuar nuk mund të ofrohet, atëherë Shteti i Kërkuar duhet të komunikojë këtë menjëherë te Shteti Kërkues, duke përfshirë edhe arsyet.
5. Nëse personi, për të cilin duhet të ekzekutohet ndihma ligjore, thirret në ndonjë imunitet, privilegj, të drejtë ose paaftësi në përputhje me ligjet e brendshme të Shtetit të Kërkuar, atëherë çështja duhet të vendoset nga organi kompetent i Shtetit të Kërkuar para ekzekutimit të kërkesës dhe vendimi përkatës duhet t'i komunikohet Shtetit Kërkues përmes Autoritetit Qendror. Nëse personi thirret në ndonjë imunitet, privilegj, të drejtë ose paaftësi në përputhje me ligjet e brendshme të Shtetit Kërkues, atëherë kjo thirrje duhet të komunikohet përmes Autoriteteve Qendrore me qëllim që organi kompetent i Shtetit Kërkues të vendos për këtë çështje.

## Neni 7

### Kërkimi i personave

Në përputhje me dispozitat e këtij Traktati, Shteti i Kërkuar do të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për të gjetur personat e dhënë në kërkesat për ndihmë juridike të cilët supozohet të gjendjet në territorin e vet.

## Neni 8

### Thirrja për seancë dhe dorëzimi i dokumenteve

1. Shteti i Kërkuar duhet t'i dorëzojë thirrjet për seancë dhe dokumentet e dërguara nga Shteti Kërkues në përputhje me ligjet vendore.
2. Shteti i Kërkuar, pas kryerjes së shërbimit, duhet t'i ofrojë Shtetit Kërkues një vërtetim dëshmuar për kryerje të shërbimit që përfshin nënshkrimin ose vulën e organi që ka zbatuar shërbimin, si dhe datën, kohën, vendin dhe modalitetet e dorëzimit, si dhe personin të cilit i janë dorëzuar dokumentet. Nëse shërbimi nuk ekzekutohet, Shteti i Kërkuar duhet të informojë, brenda një afati të arsyeshëm, Shtetin Kërkues dhe t'i komunikojë arsyet për moszekutim.
3. Kërkesat për të dorëzuar thirrjet për seancë duhet të parashtrihen Shtetit të Kërkuar brenda afatit të paraparë në paragrafin 2, të nenit 10.
4. Thirrjet për seancë dhe dokumentet e dorëzuara nuk duhet të shoqërohen nga asnjë kërcënim me masa që detyrojnë praninë në rast të mosparaqitjes.

## Neni 9

### Marrja e dëshmive në Shtetin e Kërkuar

1. Shteti i Kërkuar, në përputhje me ligjet e veta, duhet të sigurojë marrjen e dëshmive nga dëshmitarët dhe viktimat si dhe deklaratat nga personat nën hetim ose ndjekje penale, nga ekspertët ose personat tjerë, dhe duhet të merr edhe të dhënat, dokumentet dhe çdo dëshmi tjetër të shënuar në kërkesën për ndihmë ligjore dhe duhet t'i përcjellë ato tek Shteti Kërkues.
2. Shteti i Kërkuar duhet të informojë, brenda një afati të arsyeshëm, Shtetin Kërkues për datën dhe vendin ku aktivitetet për marrja e dëshmive, nga paragrafi i mësipërm, do të kryhen si dhe për qëllime të paragrafit 3, neni 6. Nëse është e nevojshme, Autoritetet Qendrore duhet të konsultohen me njëra tjetrën me qëllim të caktimit të datës të përshtatshme për të dy Shtetet.
3. Personi i thirrur për të bërë deklaratat ka të drejtën e refuzimit të bërjes së tyre nëse ligjet e Shtetit të Kërkuar ose të Shtetit Kërkues e lejojnë një gjë të tillë; në këtë drejtim, Shteti Kërkues duhet të potencojë këtë në kërkesën për ndihmë.
4. Shteti i Kërkuar duhet të lejojë praninë e avokatëve mbrojtës të personit të thirrur për të bërë deklaratat kurdo që kjo është e paraparë me ligjet e Shtetit Kërkues dhe nuk është në kundërshtim me ligjet e Shtetit të Kërkuar.
5. Dokumentet dhe sendet tjera si dëshmi, të përmendura nga personi i thirrur për të bërë deklaratat, mund të merren dhe janë të qasshme si dëshmi në Shtetin Kërkues në përputhje me ligjet e atij Shteti.



## Neni 10

### Paraqitja para autoriteteve gjyqësore të Shtetit Kërkues

1. Shteti i Kërkuar, me kërkesë të Shtetit Kërkues, fton personin për t'u paraqitur tek organi kompetent në territorin e Shtetit Kërkues për t'u marrë në pyetje, për të dhënë dëshmi ose për të bërë deklaratata tjera ose për t'u dëgjuar si ekspertë ose për të kryer aktivitete tjera procedurale. Shteti i Kërkuar duhet të informojë, brenda një afati të arsyeshëm, Shtetin Kërkues për disponueshmërinë e një personi të tillë.
2. Shteti Kërkues duhet t'i përcjellë Shtetit të Kërkuar, thirrjen për t'u paraqitur para organit në territorin e Shtetit Kërkues së paku gjashtëdhjetë ditë para datës së paraqitjes, përveç nëse Shteti Kërkues pajtohet për një afat më të shkurtër në raste urgjente.
3. Shteti Kërkues duhet të theksojë në kërkesë, shumën e shtesave ose kompensimit të shpenzimeve në të cilat ka të drejtë personi i thirrur në bazë të nenit 5, paragrafi 2, pika (g).

## Neni 11

### Garancitë dhe Parimi i Specialitetit

1. Personi që është i pranishëm në territorin e Shtetit Kërkues, në bazë të nenit 10 më sipër:
  - (a) Nuk duhet të hetohet nga Shteti Kërkues e as të ndiqet penalisht, gjykohet ose t'i nënshtrohet kurrfarë mase të heqjes së lirisë personale në lidhje me veprat penale të kryera para hyrjes në territorin e shtetit në fjalë;
  - (b) Nuk duhet të detyrohet të jap dëshmi ose të bëjë deklaratata tjera e as të merr pjesë në asnjë aktivitet të ndërlidhur me një procedurë që dallon nga ajo për të cilën është parashtruar kërkesa për ndihmë, përveç nëse Shteti i Kërkuar dhe personi në fjalë japin pëlqimin për një gjë të tillë.
2. Paragrafi 1 i këtij neni pushon së aplikuari nëse personi në fjalë:
  - (a) Nuk e lëshon territorin e Shtetit Kërkues brenda tridhjetë ditëve nga momenti në të cilin ai/ajo informohet zyrtarisht që prania e tij/saj nuk është e nevojshme më. Periudha e tillë kohore nuk do të përfshijë periudhën kur personi në fjalë nuk e ka lëshuar territorin e Shtetit Kërkues për arsye jashtë kontrollit të tij/saj;
  - (b) Pas lëshimit të territorit të Shtetit Kërkues, kthehet në të vullnetarisht.
3. Ndaj personit që nuk paraqitet, pas dërgimit të thirrjes në përputhje me dispozitat e këtij Traktati ose që refuzon të jap deklaratata ose të merr pjesë në çfarëdo aktivitete procedurale në bazë të neneve 9 ose 10 të këtij Traktati, nuk do të ushtrohen masa detyruese ose masa të heqjes së lirisë personale, përfshirë sjelljen me

forcë para gjykatëse nëse nuk paraqitet ose refuzon. Nëse kërkohet, sanksione të tjera të natyrave të ndryshme të parapara me ligjet e Shtetit të Kërkuar mund të aplikohen për rrethana të ngjashme.

4. Dëshmitari ose eksperti, që dëgjohe në përputhje me nenet 9 dhe 10 është përgjegjës për përmbajtjen e deklaratave dëshmuese ose raportet e ekspertëve ose çdo sjellje tjetër që cilësohet si vepër penale të kryer gjatë paraqitjes në gjykatë në përputhje me ligjet përkatëse të Shtetit të Kërkuar dhe Shtetit Kërkues, duke iu nënshtruar juridiksionit përkatës të secilit shtet për veprën penale.

#### Neni 12

##### Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve dhe palëve tjera që marrin pjesë në procedurat penale

Në rastet kur është e nevojshme ose për të siguruar rezultatin e hetimeve dhe administrimin korrekt të drejtësisë, të dy Shtetet duhet të miratojnë masat e parapara në ligjet e veta për mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe palëve tjera që marrin pjesë në procedurat penale duke iu referuar veprave penale dhe aktiviteteve të kërkuara.

#### Neni 13

##### Paraqitja përmes videokonferencës

1. Nëse një person është në territorin e Shtetit të Kërkuar dhe duhet të dëgjohe si dëshmitar ose ekspert nga autoritetet kompetente të Shtetit Kërkues, Shteti në fjalë mund të kërkojë që paraqitja të bëhet përmes videokonferencës, në përputhje me dispozitat e këtij neni, nëse dëshmohet se është e papërshtatshme ose e pamundshme që personi të shfaqet vullnetarisht në territorin e shtetit tjetër.

2. Paraqitja përmes videokonferencës mund të kërkohet edhe për marrjen në pyetje të një personi nën hetime ose ndjekje penale dhe për pjesëmarrjen e tij/saj në dëgjim, nëse ai/ajo jep pëlqimin dhe nëse kjo nuk është në kundërshtim me ligjet e secilit Shtet. Në atë rast, avokati mbrojtës i personit që duhet të paraqitet duhet të lejohet të jetë i pranishëm në vendin ku personi në fjalë paraqitet si në Shtetin e Kërkuar ashtu edhe para Autoritetit gjyqësor të Shtetit Kërkues, dhe avokatit mbrojtës duhet t'i mundësohet komunikimi përmes distancës, në mënyrë konfidenciale, me personin të cilit i ndihmon.

3. Paraqitja përmes videokonferencës duhet të realizohet nëse personi që duhet të dëgjohe ose merret në pyetje gjendet në mbajtje në territorin e Shtetit të Kërkuar.

4. Shteti i Kërkuar duhet të autorizojë paraqitjen përmes videokonferencës me kusht që i ka në dispozicion mjetet teknike për të realizuar atë.

5. Kërkesa për paraqitje përmes videokonferencës duhet të përfshijë, përveç asaj çka është paraparë në nenin 5, edhe arsyt pse është e papërshtatshme ose e

pamundur për personin që nuk është i paraburgosur dhe duhet të dëgjohet ose merret në pyetje, që të jetë i pranishëm personalisht në Shtetin Kërkues, si dhe të theksohet Autoriteti kompetent dhe personat që do të pranojnë deklaratën.

6. Autoriteti kompetent i Shtetit të Kërkuar duhet të ftojë personin në fjalë që të paraqitet në përputhje me ligjet e veta.

7. Sa i përket paraqitjes përmes videokonferencës, do të aplikohen dispozitat në vijim:

- (a) Autoritetet kompetente të të dyja Shteteve duhet të jenë të pranishme gjatë marrjes së dëshmive, nëse është e nevojshme edhe me përkthyes. Autoriteti kompetent i Shtetit të Kërkuar duhet të bëjë identifikimin e personit që paraqitet dhe të sigurojë se ky aktivitet kryhet në përputhje me ligjet e veta. Nëse organi kompetent i Shtetit të Kërkuar konsideron që, gjatë marrjes së dëshmive, nuk janë respektuar parimet fundamentale të ligjeve të brendshme, atëherë duhet të miratojë menjëherë masat e nevojshme ashtu që aktiviteti të kryhet në përputhje me parimet e theksuara;
- (b) Autoritetet kompetente të të dyja Shteteve duhet të pajtohen në mënyrë reciproke për masat mbrojtëse për personit e thirrur, nëse kjo është e nevojshme;
- (c) Me kërkesën e Shtetit Kërkues ose të personit që është paraqitur, Shteti i Kërkuar duhet të sigurojë përkthyes për personin në fjalë, nëse është e nevojshme;
- (d) Personi i thirrur bëjë deklaratë, ka të drejtën e refuzimit të bërjes së saj nëse ligjet e Shtetit të Kërkuar ose të Shtetit Kërkues lejojnë atë;

8. Me përjashtim të asaj që është paraparë në pikën (b) më sipër, Autoriteti kompetent i Shtetit të Kërkuar duhet të hartojë, në fund të paraqitjes, një dokument zyrtar për të raportuar datën dhe vendin e paraqitjes, detajet e identitetit të personit që është paraqitur, detajet e identitetit dhe kapacitetin e të gjithë personave që kanë marrë pjesë në aktivitet si dhe të kushteve teknike në të cilat është bërë marrja e dëshmive. Origjinali i dokumentit zyrtar në fjalë duhet të dërgohet, brenda një afati të arsyeshëm, nga ana e organit kompetent të Shtetit të Kërkuar te organi kompetent i Shtetit Kërkues, përmes Autoriteteve Qendrore të përcaktuara në nenin 4.

9. Shpenzimet e shkaktuara nga Shteti i Kërkuar për të kryer videokonferencën duhet të kompensohen nga Shteti Kërkues, përveç nëse Shteti i Kërkuar heq dorë nga kompensimi në tërësi ose pjesërisht.

10. Shteti i Kërkuar mund të lejojë përdorimin e teknologjisë së videokonferencës edhe për qëllime tjera nga ato të specifikuar në paragrafët 1 dhe 2 më sipër, përfshirë edhe për njohjen e personave dhe sendeve si dhe për konfrontime.

## Neni 14

### Transferimi i përkohshëm i të pandehurve

1. Në rastet kur videokonferenca, e paraparë me nenin 14, paragrafi 4, nuk është e mundur me kërkesës së Shtetit Kërkues, Shteti i Kërkuar ka të drejtën e transferimit të përkohshëm në Shtetin Kërkues një personi të paraburgosur në territorin e vet për t'i mundësuar atij/asaj të paraqitet para organit kompetent për t'u marrë në pyetje, për të dhënë dëshmi ose për të ndonjë lloj tjetër të deklaratës, ose për të marrë pjesë në aktivitete tjera procedurale me kusht që personi në fjalë jep pëlqimin për një gjë të tillë dhe se është arritur marrëveshje me shkrim ndërmjet Shteteve për transferimin dhe si kushtet përkatëse.
2. Transferimi i përkohshëm i një personi mund të zbatohet me kusht që:
  - (a) nuk ndërhyt me hetime ose ndjekje penale që janë duke u kryer në Shtetin e Kërkuar, në të cilat personi në fjalë duhet të marrë pjesë; dhe
  - (b) personi i transferuar mbahet në paraburgim në Shtetin Kërkues.
3. Koha e kaluar në paraburgim në Shtetin Kërkues duhet të llogaritet për qëllime të ekzekutimit të dënimeve të shqiptuara në Shtetin e Kërkuar.
4. Nëse me qëllim të ekzekutimit të transferimit të përkohshëm, kërkohet tranziti i personit të paraburgosur nëpër një shtet të tretë, Shteti Kërkues kur është e nevojshme, duhet t'i dorëzojë organit kompetent të shtetit të tretë kërkesën për tranzit dhe të informojë me kohë Shtetin e Kërkuar për rezultatin e kërkesës në fjalë, duke përcjell dokumentacionin relevant.
5. Shteti Kërkues duhet menjëherë t'i kthejë Shtetit të Kërkuar personin e transferuar pas përfundimit të aktiviteteve të parapara në paragrafin I të këtij neni ose në fund të ndonjë afati tjetër kohor të miratuar në mënyrë specifike ndërmjet Autoriteteve Qendrore të dy Shteteve.
6. Personi i transferuar përkohësisht në përputhje me këtë nen duhet të gëzojë, aty ku është e mundur, garancitë e parapara me nenin 11.
7. Transferimi i përkohshëm mund të refuzohet nga Shteti i Kërkuar kur ka arsye të mëdha dhe substanciale.

## Neni 15

### Ofrimi i dokumenteve zyrtare ose publike

1. Në bazë të kërkesës, Shteti i Kërkuar duhet t'i ofrojë Shtetit Kërkues origjinalet ose kopjet e vërtetuara të të dhënave ose dokumentet nga zyrat shtetërore ose organet publike të cilat janë në dispozicion për publikun.
2. Shteti i Kërkuar mund të ofrojë origjinalet ose kopjet e certifikuara të të dhënave ose dokumenteve nga zyrat shtetërore ose organet publike që nuk janë në dispozicion për publikun deri në atë masë dhe nën kushtet e tilla që kopjet e tilla do të ishin në dispozicion për Autoritetet zbatuese të ligjit dhe ato gjyqësore në Shtetin e

Kërkuar. Shteti i Kërkuar mund të refuzojë, nën diskrecion, kërkesën e lartpërmendur në tërësi ose pjesërisht.

#### Neni 16

##### Ofrimi i dokumenteve, të dhënave ose gjësendeve

1. Në rastet kur kërkesa për ndihmë ligjore ka të bëjë me përcjelljen e dokumenteve ose të dhënave, përveç atyre të parapara në nenin 15 më sipër, Shteti i Kërkuar mund të përcjell origjinalet ose kopjet e certifikuara të tyre. Megjithatë, në rastet kur Shteti Kërkues kërkon në mënyrë eksplicite përcjelljen e origjinaleve, Shteti i Kërkuar duhet të plotësojë këtë kërkesë nëse është e mundur.
2. Me kusht që kjo të mos jetë në kundërshtim me ligjet e Shtetit të Kërkuar, dokumentet dhe materialet tjera që duhet përcjellë Shtetit Kërkues në përputhje me këtë nen, duhet të certifikohen sipas modaliteteve të specifikuara nga Shteti Kërkues, me qëllim që ato të jenë të pranueshme në bazë të ligjeve të atij Shteti.
3. Origjinalet e dokumenteve dhe të dhënave si dhe gjësendet e përcjella te Shteti Kërkues, duhet t'i kthehen Shtetit të Kërkuar sa më shpejt që është e mundur, kurdo që kjo e fundit kërkon atë.

#### Neni 17

##### Kontrollet, sekuestrimet dhe konfiskimet

1. Shteti i Kërkuar, me kërkesë të Shtetit Kërkues, duhet të kryejë verifikimet ose hetimet e kërkuara për të konstatuar nëse ka mjete që janë përdorë për kryerjen e veprës penale ose pasuri e fituar me vepër penale brenda territorit të vet dhe duhet t'i komunikojë Shtetit Kërkues rezultatin e kërkesës së tillë. Gjatë bërjes së kërkesës, Shteti Kërkues duhet t'i komunikojë Shtetit të Kërkuar arsyet pse mjetet ose sendet e fituara ose ndërlidhura me vepër penale mund të jenë në territorin e Shtetit të Kërkuar.
2. Pasi të gjurmohen mjetet që janë përdorë për kryerjen e veprës penale ose pasuria e fituar me vepër penale, të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, Shteti i Kërkuar me kërkesë të Shtetit Kërkues, duhet të miratojë çdo masë të paraparë me ligjet e veta për të ngrirë, sekuestruar dhe konfiskuar mjetet ose gjësendet e tilla të ndërlidhura me veprën penale në përputhje me nenin 6 të këtij Traktati.
3. Me kërkesë të Shtetit Kërkues, Shteti i Kërkuar duhet t'i transferojë Shtetit Kërkues, të gjitha mjetet dhe sendet e ndërlidhura me vepër penale, në tërësi ose pjesërisht, si dhe të gjitha mjetet e mbledhura nga shitja e sendeve, në bazë të kushteve të miratuara ndërmjet tyre.
4. Gjatë zbatimit të këtij neni, duhet të respektohen të gjitha të drejtat e Shtetit të Kërkuar ose palëve të treta në lidhje me mjetet ose gjësendet e ndërlidhura me veprën penale.

## Neni 18

### Identifikimi i informatave bankare dhe financiare

1. Me kërkesë të Shtetit Kërkues, Shteti i Kërkuar duhet të konstatojë nëse personi i identifikuar fizik ose juridik, i cili është i dyshuar ose i akuzuar për kryerjen e një vepre penale, ka të hapur një ose më shumë llogari bankare në cilindo bankë në territorin e vet dhe duhet t'i përcjellë Shtetit Kërkues informatat përkatëse, përfshirë informatat në lidhje me identitetet e individëve të autorizuar për shfrytëzim të atyre llogarive, vendndodhjen dhe çdo transaksion të ndërlidhur.
2. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të aplikohet edhe për institucione tjera financiare e jo vetëm për banka.
3. Shteti i Kërkuar duhet të informojë, brenda një afati të arsyeshëm, Shtetin Kërkues për rezultatin e kërkesës.
4. Ndihma e përmendur në këtë nen nuk mund të refuzohet me arsyetim të konfidencialitetit bankar.

## Neni 19

### Përputhshmëria me instrumentet tjera për bashkëpunim ose ndihmë

1. Dispozitat e këtij Traktati nuk duhet të çenojnë asnjë të drejtë të pranuar ose obligim të ndërmarrë nga cilido Shtet përmes nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Ky Traktat nuk duhet të parandalojë Shtetet nga ofrimi i formave tjera të bashkëpunimit dhe ndihmës ligjore në bazë të marrëveshjeve dhe rregullimeve specifike ose praktikave të ndara, nëse janë në përputhje me sistemet përkatëse ligjore. Në këtë drejtim, ndihma ligjore mund të kërkohej edhe në këto raste:
  - (a) Për të themeluar ekipe të përbashkëta hetimore për të operuar në territorin e cilitdo Shtet me qëllim të lehtësimit të hetimit ose të procedurave penale të ndërlidhura me vepra penale që përfshijnë të dy Shtetet;
  - (b) Kryerjen e dërgesave të kontrolluara në territorin e Shtetit të Kërkuar;
  - (c) Ndihma për zyrtarët e zbatimit të ligjit të Shtetit Kërkues për të kryer aktivitetet të fshehta në territorin e Shtetit të Kërkuar;
  - (d) Kryerjen e vëzhgimit, përcjelljen dhe kontrollimin e personave të dyshuar për pjesëmarrje në kryerjen e veprave penale serioze, në territorin e Shtetit të Kërkuar, përmes zyrtarëve të zbatimit të ligjit të Shtetit Kërkues.

3. Në lidhje me aktivitetet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të vlejnjë dispozitat në vijim:

- (a) Ndhimja duhet të ofrohet me kusht që vepra për të cilën kërkohet ndihma paraqet një vepër penale në bazë të ligjeve të të dy Shteteve, sipas paragrafit 2 të nenit 2;
- (b) Kërkesa për ndihmë duhet të konsiderohet dhe të vendoset nga ana e autoritetit kompetent të Shtetit të Kërkuar varësisht nga rasti, në përputhje me ligjet e veta dhe dispozitat e këtij Traktati;
- (c) Organi prokurorial i Shtetit Kërkues dhe organi kompetent i Shtetit të Kërkuar duhet të pajtohen, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe preliminare, për të gjitha detajet e aktivitetit, përfshirë organizimin, procedurën operative që duhet ndjekur, kush duhet të merr pjesë në të dhe në çfarë cilësie, të gjitha kushtet specifike të cilat duhet të respektohen dhe sa duhet të zgjasë një aktivitet i tillë. Këto rregullime duhet t'i komunikohen Autoriteteve Qendrore të përcaktuara në bazë të nenit 4, vetëm në atë masë dhe mënyrë që informatat e ofruara të mos rrezikojnë konfidencialitetin e operacionit dhe sigurinë e personave të përfshirë;
- (d) Aktiviteti i kërkuar duhet të zbatohet në përputhje me procedurat e parapara me ligjin e Shtetit të Kërkuar dhe nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e organit kompetent të atij Shteti;
- (e) Përveç arsyeve të parapara në nenin 3, Shteti i Kërkuar mund të refuzojë ofrimin e ndihmës juridike edhe në bazë të natyrës ose seriozitetit të pamjaftueshëm të veprës penale ose me arsyetime tjera të bazuara mirë, të cilat duhet t'i komunikohen Shtetit Kërkues.

#### Neni 20

##### Shkëmbimi i informatave për procedurat penale

Shteti i Kërkuar duhet t'i përcjell Shtetit Kërkues, për qëllime të kryerjes së procedurave penale për të cilat është bërë kërkesa për ndihmë juridike, informatat për procedura penale, akuzat e mëparshme dhe dënimet e shqiptuara në vendin e vet kundër qytetarëve të Shtetit Kërkues.

#### Neni 21

##### Shkëmbimi i informatave rreth ligjeve

Në bazë të kërkesës, Shtetet duhet të shkëmbejnë informata rreth ligjeve në fuqi ose të cilat kanë qenë në fuqi dhe për praktikat gjyqësore të ndjekura në vendet e tyre duke iu referuar zbatimit të këtij Traktati.

## Neni 22

### Përcjellja e aktgjykimeve dhe certifikatave të regjistrave penal

1. Në rastet kur Shteti i Kërkuar dërgon një aktgjykim penal, po ashtu duhet të ofrojë edhe informata rreth procedurave përkatëse nëse kjo kërkohet nga Shteti Kërkues.
2. Certifikatat e regjistrave penale të cilat janë të nevojshme për Autoritetit gjyqësor të Shtetit Kërkues për qëllime të procedurave penale, duhet t'i përcillen Shtetit në fjalë nëse ato mund të lëshohen në rrethana të njëjta Autoriteteve gjyqësore të Shtetit të Kërkuar.

## Neni 23

### Lirimi nga legalizimi dhe validiteti i dokumenteve dhe regjistrave

Dokumentet dhe regjistrat e dërguara në përputhje me këtë Traktat nuk kanë nevojë për legalizim ose apostilim dhe duhet të jenë plotësisht të pranueshme si dëshmi në Shtetin Kërkues.

## Neni 24

### Konfidencialiteti

1. Shteti i Kërkuar duhet të trajtojë me konfidencialitet kërkesën për ndihmë ligjore, përfshirë përmbajtjen, dokumentet përcjellëse dhe çdo dokument të pranuar ose të fituar gjatë ekzekutimit të së njëjtës, nëse kjo kërkohet nga Shteti Kërkues. Nëse kërkesa nuk mund të ekzekutohet pa shkelur konfidencialitetin, Shteti i Kërkuar duhet të informojë Shtetin Kërkues, i cili duhet të vendos nëse prapëseprapë dëshiron ta zbatojë kërkesën.
2. Shteti Kërkues duhet të trajtojë si konfidenciale informatat ose dëshmitë e dorëzuara nga Shteti i Kërkuar, nëse ky i fundit kërkon një gjë të tillë.

## Neni 25

### Shpenzimet

1. Shteti i Kërkuar duhet të merr përsipër shpenzimet e ndërlidhura me ekzekutimin e kërkesës për ndihmë juridike. Megjithatë, Shteti Kërkues duhet të merr për sipër:



- (a) Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Shtetin e Kërkuar të personave të përmendur në nenin 6, paragrafi 3;
- (b) Shtesat dhe shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Shtetin Kërkuar të personave të përmendur në nenin 10;
- (c) Shpenzimet e shkaktuara nga ekzekutimi i kërkesës së përmendur në nenin 12;
- (d) Shpenzimet e shkaktuara për qëllimet e përmendura në nenin 13;
- (e) Shpenzimet për videokonferenca, pa paragjykuar paragrafin 9, të nenit 14;
- (f) Shpenzimet dhe pagesat e ekspertëve;
- (g) Shpenzimet dhe pagesat për përkthim dhe interpretim si dhe kostoja e transkriptimit;
- (h) Shpenzimet e ruajtjes dhe dorëzimit të sendeve të sekuestruara.

2. Nëse është e qartë se ekzekutimi i kërkesës përfshin shpenzime të natyrës së jashtëzakonshme, Shtetet duhet të konsultohen me qëllim të arritjes së pëlqimit rreth kushteve nën të cilat kërkesa duhet të ekzekutohet dhe kriteret për ndarjen e shpenzimeve relevante.

#### Neni 26

#### Zgjidhja e kontesteve

1. Çdo kontest që mund të shfaqet në lidhje me interpretimin ose aplikimin e Traktatit aktual duhet të zgjidhet përmes konsultimeve ndërmjet Autoriteteve Qendrore.
2. Nëse nuk arrihet marrëveshje, atëherë kontesti duhet të zgjidhet me konsultime përmes kanaleve diplomatike.

#### Neni 27

#### Hyrja në fuqi, amandamentimi dhe ndërprerja

1. Ky Traktat duhet të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit përmes të cilit Palët Kontraktuese i komunikojnë njëra-tjetrës, përmes kanaleve diplomatike, që procedurat e brendshme përkatëse të ratifikimit janë përfunduar.
2. Ky Traktat mund të amendamentohet në çdo kohë përmes marrëveshjes me shkrim ndërmjet Palëve Kontraktuese. Çdo amendament i tillë duhet të hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni dhe do të jetë pjesë përbërëse e këtij Traktati.


3. Ky Traktat duhet të ketë kohëzgjatje të pakufizuar. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën e tërheqjes nga ky Traktat në çdo kohë me dorëzimin e njoftimit me shkrim Palës tjetër përmes kanaleve diplomatike. Ndërprerja duhet të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën është bërë njoftimi. Ndërprerja e zbatimit nuk duhet të ketë ndikim mbi procedurat e filluara para ndërprerjes në fjalë.

4. Ky Traktat duhet të vlejë për të gjitha kërkesat e dorëzuara pas hyrjes në fuqi, edhe nëse veprat penale përkatëse janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij Traktati.

DUKE QENË DËSHMITAR, i poshtë-nënshkruari, i autorizuar sipas rregullit nga Qeveria përkatëse, ka nënshkruar këtë Traktat.

EKZEKUTUAR në Prishtinë, në këtë ditë 19 të muajit Qershor të vitit 2013  
në dy kopje të gjuhës shqipe, serbe, italiane dhe angleze, dhe të gjitha tekstet janë autentike.

Në rast të mospërputhjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze duhet të mbizotërojë.



Për Qeverinë e Republikës  
së Kosovës



Për Qeverinë e Republikës së  
Italisë